

NJOFTIM PËR PËRDORUESIT MBI RISHIKIMIN E LLOGARIVE KOMBËTARE

Qershor 2026

Norma Instituti i Statistikave (INSTAT), si autoriteti kombëtar përgjegjës për përpilimin dhe publikimin e Llogarive Kombëtare në Shqipëri, informon përdoruesit mbi rishikimin e planifikuar të të dhënave të Llogarive Kombëtare në Qershor 2026.

Ky rishikim është pjesë e aktivteteve të vazhdueshme të INSTAT, për të përmirësuar cilësinë, konsistencën, plotshmërinë në seri kohore të statistikave makroekonomike, si dhe për të siguruar përafrimin gradual të tyre me standardet statistikore të Bashkimit Evropian, në veçanti me Sistemin Evropian të Llogarive (ESA 2010), si dhe me rekomandimet përkatëse të Eurostat.

Në kontekstin e procesit të integrit të Shqipërisë në BE, ky rishikim përfaqëson një hap të rëndësishëm drejt forcimit të përputhshmërisë me acquis-in statistikor të BE-së dhe rritjes së krahasueshmërisë së treguesve makroekonomikë të vendit brenda kuadrit statistikor evropian.

Rishikimi i qershorit 2026 pason rishikimin madhor të kryer në vitin 2024, dhe përbën një përditësim të planifikuar ndërmjetës, me qëllim përmirësimin e saktësisë, plotshmërisë së treguesve dhe serive kohore të të dhënave, si dhe konsistencës së brendshme të të dhënave të Llogarive Kombëtare. Rishikimi do të përfshijë përmirësimet kryesore të mëposhtme:

- **Integrimi i burimeve të reja dhe të përditësuara të të dhënave**
 - Përfshirja e rezultateve të CESNS (Censusi i Popullsisë dhe Banesave) 2023;
 - Përfshirja e përditësimit të burimeve administrative dhe statistikore;
 - Përmirësim i sistemeve të integrit të informacionit të disponueshëm për vlerësimin e agregatëve kryesorë makroekonomikë.
- **Përmirësimet metodologjike**
 - Përafrim i mëtejshëm me konceptet, përkufizimet dhe praktikat e ESA 2010;
 - Përmirësimet në metodat e vlerësimit, përfshirë metodën e deflatimit dhe matjen e treguesve në volum;
 - Harmonizimi i koncepteve të çmimeve (çmime aktuale, çmime të vitit paraardhës dhe vlera të lidhura zinxhir);
 - Zbatimi i klasifikimit të ri COICOP 2018 "Klasifikimi i Konsumit Individual sipas Qëllimit (COICOP 2018)", në vlerësimin e treguesit "Shpenzime e konsumit final të familjeve".

- **Përmirësimi i konsistencës së brendshme të sistemit të vlerësimit të Llogarive Kombëtare**
 - Rritje e koherencës ndërmjet tre metodave të vlerësimit të PBB-së: prodhimit, shpenzimeve dhe të ardhurave;
 - Përmirësim i konsistencës ndërmjet Llogarive Kombëtare në terma vjetore dhe tremujore;
 - Përmirësime në vlerësimin e Llogarive Kombëtare sipas sektorëve institucionalë, veçanërisht sektorin e Qeverisjes së Përgjithshme (S.13).
- **Plotësimi dhe zgjerimi i serive kohore**
 - Përmirësimi i mbulimit të agregatëve kryesorë, përfshirë komponentët e të ardhurave, investimet, ndryshimet në inventarë dhe transaksionet e bilancit tregtar;
 - Zgjerimi i serive kohore për të siguruar tregues të qëndrueshëm për analizën e zhvillimeve ekonomike në Shqipëri.
- **Ndikimi i pritshëm i rishikimit**

Si rezultat i këtij rishikimi, përdoruesit mund të vërejnë:

 - Rishikime në nivelin dhe normat e rritjes së PBB-së dhe komponentëve kryesorë të saj;
 - Përditësime në shpenzimet e konsumit final të familjeve, përfshirë ndikimet nga zbatimi i klasifikimit të ri COICOP 2018;
 - Rishikime në treguesit e punësimit sipas koncepteve të llogarive kombëtare, llogaritë sipas sektorëve institucionalë;
 - Përmirësime në konsistencën e brendshme, besueshmërinë e të dhënave dhe krahasueshmërinë ndërkombëtare.
- **Zhvillimi i vazhdueshëm i Llogarive Kombëtare**
 - Ky rishikim duhet parë si pjesë e një procesi të vazhdueshëm zhvillimi dhe përmirësimi të Llogarive Kombëtare në Shqipëri.
 - INSTAT mbetet i angazhuar në përmirësimin e mëtejshëm të fushës, cilësisë dhe përdorshmërisë së produkteve të tij, duke siguruar përputhshmëri me standardet e aplikuara në Bashkimin Evropian.
 - Përdoruesit mund të presin përmirësime të mëtejshme metodologjike, zgjerim të të dhënave dhe produkte statistikore më të avancuara në të ardhmen.

- **Shpërndarja dhe komunikimi**

INSTAT siguron transparencë të plotë ndaj përdoruesve duke publikuar njoftimin paraprakisht, në përputhje të plotë me Politikën dhe Udhëzimet për Shpërndarjen e të Dhënave të INSTAT, të cilat janë të publikuara në faqen zyrtare në linkun: [politika-e-shperndarjes-se-informacionit-statistikor-2025.pdf](https://www.instat.gov.al/politika-e-shperndarjes-se-informacionit-statistikor-2025.pdf).

Të dhënat e rishikuara do të publikohen në qershor 2026, së bashku me:

- Një analizë të detajuar të ndikimit të rishikimit;
- Dokumentacion metodologjik dhe metadata të përditësuara;